

KUSH E FINANCON DDLS?

Qeveria e Komonuelthit

A MË DUHET MUA TË PAGUAJ?

Zakonisht shërbimet janë falas.

Ndonjëherë mund t'ju duhet të paguani për shpenzimet ekstra ose për kosto të tjera. Nëse ju ndodhë kjo situatë atëherë ne do ta diskutojmë këtë së bashku.

Dhuratat janë të mirëpritura gjithashtu!

A MUND TË MARR NJË PËRKTHYES?

Zakonisht (por jo gjithmonë) DDLS mund të organizojë që përkthyesit t'ju sigurohen falas.

Kjo broshurë është e vlefshme në gjuhë të tjera në faqen tonë të internetit. Broshurat e gjuhëve të ndryshme janë financuar nga Legal Practitioner Interest Trust Accounts Grant Fund.

Informacioni në këtë broshurë është aktual në Tetor të vitit 2006. Mund t'i bëhen ndryshime pa ju lajmëruar.

A DËSHIRONI TË DINI MË SHUMË?

Kontakttoni Disability Discrimination Legal Service (Shërbimi Ligjor kundër Diskriminimit në rast Paaftësie Fizike).

Adresa:

Cairns Community Legal Centre Inc
(duke Përfshirë Disability Discrimination Legal Service) (Shërbimin Ligjor për Diskriminimin në rast Paaftësie Fizike)
Level 1
Main Street Arcade
85 Lake Street
(PO Box 7129)
CAIRNS Q 4870

Ka hyrje për karrocë invalidi në ndërtesë.

Telefoni:

(07) 4031 7358 (për klientat e DDLS në Cairns)
1800 650 197 (për klientat e DDLS jashtë Cairnsit)

Adresa e Internetit:

www.cclc.org.au

I dërgojmë falenderimet tona vullnetarëve bujarë që dhurojnë kohën e tyre për të ndihmuar Cairns Community Legal Centre Inc dhe objektivat e saj.

Pa këto njerëz Qendra nuk do të kishte qënë në gjendje për të siguruar shumë nga shërbimet që siguron.

Këshillim ligjor FALAS, shërbime informacioni dhe rekomandimi të vlefshme në

**DISABILITY
DISCRIMINATION
LEGAL
SERVICE**

Shërbimi Ligjor kundër Diskriminimit në rast Paaftësie Fizike i vendosur pranë Cairns Community Legal Centre Inc (Qendra Ligjore e Komunitetit në Cairns)



ÇFARË ËSHTË DISABILITY DISCRIMINATION LEGAL SERVICE?

Disability Discrimination Legal Service (DDLS) (Shërbimi Ligjor Kundër Diskriminimit në rast Paftësie Fizike) është një shërbim i specializuar ligjor për njerëzit me paftësi fizike që janë trajtuar padrejtësisht për arsye të paftësisë së tyre fizike.

KUSH E SIGURON DDLS?

DDLS sigurohet nga Cairns Community Legal Centre Inc (the Centre) (Qendra). Qendra është një organizatë jo për përfitim e komunitetit e drejtuar nga vullnetarë dhe një numër i vogël nëpunësash.

ÇFARË DO TË THOTË ‘PAAFTËSI FIZIKE’?

Paftësia fizike është e përkufizuar në mënyrë shumë të gjërë.

Më poshtë janë vetëm pak shembuj:

- Paftësitë fizike
- Sëmundje të tilla si HIV/AIDS ose Hepatiti C
- Gjendja epileptike, diabeti, sëmundja e mungesës së oreksit ose sklerozë komplekse
- Çrregullimet e shikimit, ndigjimit apo lëvizjes
- Sëmundje mendore
- Paftësi intelektuale (mendore)

Ankesat kundër diskriminimit të bërë mbi bazën e paftësisë mund të bëhen në vendet e punës, arsimimit, strehimit, shitjes së mallrave dhe shërbimeve, pensionet, siguracionet dhe klubet.

ÇFARË BËN DDLS NË RASTE TË TILLA?

DDLS siguron këshillim ligjor FALAS për çështjet e diskriminimit në lidhje me paftësitë.

DDLS siguron përfaqësim vetëm në rrethana të kufizuara.

SI TË MARR KESHILLIM LIGJOR?

Këshillimi ligjor bëhet me takim. Telefononi DDLS për të organizuar një takim.

EDUKIMI LIGJOR I KOMUNITETIT

DDLS mban gjithashtu edhe bisedime, punishte dhe seminare për grupet e komunitetit rreth çështjeve të diskriminimit në rast paftësie fizike ose mendore.

Telefononi DDLS nëse keni më shumë pyetje.

SHËRBIMET E REKOMANDIMIT

Fatkeqësisht DDLS s’mund t’ju ndihmojnë gjithmonë.

Nëse DDLS s’mund t’ju ndihmojnë ne do të bëjmë të pamundurën për t’ju rekomanduar tek një organizatë e përshtatëshme për nevojën tuaj.

KUSH MUND TË PËRDORË DDLS?

DDLS është i vlefshëm për njerëzit me paftësi që jetojnë në Kuinslandën Veriore (zona nga Sarina, në Perëndim të Northern Territory dhe në Veri të Torres Strait). Në disa raste, ‘shoqëruesit’ e njerëzve me paftësi, si p.sh. shokë, partnerë apo kujdestarë, mund të përdorin DDLS gjithashtu.